



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
KOMISIONI PËR SIGURINË KOMBËTARE

Tiranë më 10.10.2019
Dokument parlamentar

RAPORT
PËR PROJEKTLIGJIN “PËR MASAT SHTRËNGUESE NDËRKOMBËTARE
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

- ***Hyrje***

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, bazuar në nenet 32-36 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e komisionit përgjegjës, shqyrtoi në mbledhjen e datës 10.10.2019 në parim, nen për nen dhe në tërësi, projektligjin “*Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë*”.

Për të prezantuar projektligjin në komision ishin të pranishëm Zëvendësministri për Europën dhe Punët e Jashtme Z.Etjen Xhafaj bashkë me stafin mbështetës.

Relatore e projektligjit u caktua deputetja Artemis Dralo.

- ***Baza kushtetuese e projektligjit***

Iniciativa ligjore për hartimin e projektligjit “Për zbatimin e masave shtrënguese ndërkombëtare” është në përputhje me nenet 5, 78, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës.

- ***Qëllimi, përmbajtja dhe risitë e projektligjit***

Qëllimi i këtij projektligji është vendosja dhe zbatimi i masave shtrënguese ndërkombëtare në funksion të ruajtjes së paqes dhe sigurisë, parandalimit të konflikteve ndërkombëtare, mbështetjes dhe forcimit të demokracisë, sundimit të ligjit, të të drejtave të njeriut, si dhe arritja e objektivave të tjerë të sigurisë së përbashkët, në përputhje me rezolutat përkatëse të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, akteve të organizatave të tjera ndërkombëtare apo marrëveshjeve ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë.

Shqipëria zbaton sanksionet ndërkombëtare të vendosura nga KS-ja dhe masat shtrënguese të BE-së, të cilat ndiqen në përputhje me angazhimet e politikës së jashtme të Shqipërisë, që rrjedhin nga neni 8, i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, e 2006 (MSA).

Aktualisht, vendi ynë zbaton ato masa shtrënguese ndërkombëtare të ndërmarra në kuadër të rezolutave të KSOKB-së, natyra e të cilave lidhet me terrorizmin apo financimin e terrorizmit, bazuar në ligjin nr.157/2013 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”.

Megjithatë ka një boshllëk ligjor lidhur me masat shtrënguese që nuk lidhen me terrorizmin apo financimin e tij, por që kanë të bëjnë me financimin e armëve të shkatërrimit në masë dhe që lidhen me zbatimin e drejtpërdrejtë të rezolutave të dala në zbatim të kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara, për ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, për shtetet anëtare të saj. Duke qenë se natyra e sanksioneve ka ndryshuar që nga themelimi i OKB-së është mjaft e rëndësishme që shtetet të angazhohen për të pasur mekanizma ligjorë kombëtarë për zbatimin e sanksioneve.

Procedurat e zbatimit të masave shtrënguese, që nuk lidhen me terrorizmin, apo financimin e tij, nuk janë të përcaktuara me ligj apo në ligje specifike, gjithashtu edhe procedura e ankimit ndaj masave shtrënguese dhe listimit që mund t’i bëhet një personi juridik apo fizik për shkak të një mase shtrënguese, duke krijuar kështu një vakuum ligjor.

Me qëllim zbatimin nga Republika e Shqipërisë të masave shtrënguese ndërkombëtare të ndërmarra në kuadër të rezolutave të (KS)-së, natyra e të cilave nuk lidhet me terrorizmin apo financimin e terrorizmit, ka lindur nevoja e krijimit të një baze ligjore për zbatimin e tyre.

Objekti kryesor i politikës që propozohet me kete projektligj është përcaktimi në mënyrë të detajuar i llojeve të sanksioneve ndërkombëtare, procedurave dhe mekanizmave të vendosjes së këtyre sanksioneve, mekanizmave të zbatimit dhe monitorimit të masave shtrënguese, procedurave dhe mekanizmave të ankimit ndaj sanksioneve.

Kjo politikë synon të kontribuojë në:

- paqen dhe sigurinë rajonale e ndërkombëtare;
- promovimin e respektit për të drejtën ndërkombëtare dhe të drejtat e njeriut;
- përkrahjen e parimeve demokratike dhe sundimit të ligjit;

Kjo politikë synon gjithashtu:

- të zbatojë detyrimet që burojnë nga anëtarësimi i vendit tonë në organizata ndërkombëtare si dhe, nga dëshira për anëtarësim në organizata ndërkombëtare;
- të sigurojë zbatimin e efektshëm të masave shtrënguese ndërkombëtare me fokus parandalimin e përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë, duke ngrirë fondet dhe pasuritë e subjekteve përkatëse si dhe,
- të vendosë sanksione për subjektet që dështojnë t’i binden atyre

Projektligji është strukturuar në tre kapituj, me 22 nene dhe çdo nen është hartuar dhe parashikon përmbushjen e detyrimit të nenit 1, i cili përcakton se vendosja dhe zbatimi i masave shtrënguese ndërkombëtare bëhet në funksion të ruajtjes së paqes dhe sigurisë, parandalimit të konflikteve ndërkombëtare, mbështetjes dhe forcimit të demokracisë, sundimit të ligjit, respektimit të të drejtave të njeriut, si dhe arritjen e objektivave të tjerë të sigurisë së përbashkët, në përputhje me rezolutat përkatëse të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, akteve të organizatave të tjera ndërkombëtare apo marrëveshjeve ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë.

- *Diskutimi në komision*

Zëvendësministri Z.Etjen Xhafaj ,në fjalën e tij u shpreh se projektligji ka për qëllim vendosjen dhe zbatimin e masave shtrënguese ndërkombëtare në funksion të ruajtjes së paqes dhe sigurisë, parandalimit të konflikteve ndërkombëtare, mbështetjes dhe forcimit të demokracisë, sundimit të ligjit, të të drejtave të njeriut, si dhe arritja e objektivave të tjerë të sigurisë së përbashkët, në përputhje me rezolutat përkatëse të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, akteve të organizatave të tjera ndërkombëtare apo marrëveshjeve ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë.

Përveç përmbushjes së qëllimit për ruajtjen e paqes e të sigurisë, ky projektligj ka si objektiv edhe përmbushjen e detyrimeve që vendi ynë ka si vend anëtar i Kombeve të Bashkuara për zbatimin e rezolutave të OKB-së, që dalin në zbatim të kreut VII (Veprime në rast të rrezikimit të paqes, të prishjes së paqes dhe të kryerjes së një akti agresioni) të Kartës së Kombeve të Bashkuara, si dhe rekomandimet e Task-Forcës për Veprim Financiar (TFVF) që kanë rishikuar standardet ndërkombëtare sa i përket luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Konkretisht, përmendim rekomandimin 6 mbi “Sanksionet specifike financiare të lidhura me terrorizmin dhe financimin e tij” dhe rekomandimin 7, mbi “Sanksionet specifike financiare të lidhura me përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë”. Në këtë frymë vijnë edhe rekomandimet e Komitetit MONEYVAL (organizëm monitorues i Këshillit të Evropës nën varësinë direkte të Komitetit të Këshillit të Ministrave të Këshillit të Evropës), i cili është organizëm monitorues i Këshillit të Evropës nën varësinë e Komitetit të Këshillit të Ministrave të Këshillit të Evropës, apo detyrimi për zbatimin e masave shtrënguese të BE-së në vijim të politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurisë (CFSP), në kuadër kjo edhe të aspiratës për anëtarësim në BE.

Mandej ai shtoi se kjo iniciativë ligjore është në përputhje me objektivat e qeverisë dhe mbështet pikërisht objektivat e përcaktuar në Planin Kombëtar të Integritimit Evropian 2019-2021, kapitulli 24, “Drejtësia, liria dhe siguria” si dhe është pjesë e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve, miratuar për vitin 2019 me vendimin nr.37, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave.

Relatorja e projektligjit, Znj.Artemis Dralo u shpreh parimisht dakort me projektligjin duke vënë edhe njëherë theksin tek rëndësia e tij dhe objektivat që synohen të arrihen nëpërmjet tij.

Ajo u shpreh se qëllimi i këtij projektligji është vendosja dhe zbatimi i masave shtrënguese ndërkombëtare në funksion të ruajtjes së paqes dhe sigurisë, parandalimit të konflikteve ndërkombëtare, mbështetjes dhe forcimit të demokracisë, sundimit të ligjit, të drejtave të njeriut, si dhe arritja e objektivave të tjerë të sigurisë së përbashkët, në përputhje me rezolutat përkatëse të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, akteve të organizatave të tjera ndërkombëtare apo marrëveshjeve ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë.

Mandej, ajo theksoi se Shqipëria zbaton sanksionet ndërkombëtare të vendosura nga KS-ja dhe masat shtrënguese të BE-së, të cilat ndiqen në përputhje me angazhimet e politikës së jashtme të Shqipërisë, që rrjedhin nga neni 8, i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, e 2006 (MSA).

Aktualisht, vendi ynë zbaton ato masa shtrënguese ndërkombëtare të ndërmarra në kuadër të rezolutave të KSOKB-së, natyra e të cilave lidhet me terrorizmin apo financimin e terrorizmit, bazuar në ligjin nr.157/2013 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”.

Megjithatë ka një boshllëk ligjor lidhur me masat shtrënguese që nuk lidhen me terrorizmin apo financimin e tij, por që kanë të bëjnë me financimin e armëve të shkatërrimit në masë dhe që lidhen me zbatimin e drejtpërdrejtë të rezolutave të dala në zbatim të kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara, për ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, për shtetet anëtare të saj. Duke qenë se natyra e sanksioneve ka ndryshuar që nga themelimi i OKB-së është mjaft e rëndësishme që shtetet të angazhohen për të pasur mekanizma ligjorë kombëtarë për zbatimin e sanksioneve.

Procedurat e zbatimit të masave shtrënguese, që nuk lidhen me terrorizmin, apo financimin e tij, nuk janë të përcaktuara me ligj apo në ligje specifike, gjithashtu edhe procedura e ankimit ndaj masave shtrënguese dhe listimit që mund t’i bëhet një personi juridik apo fizik për shkak të një mase shtrënguese, duke krijuar kështu një vakuum ligjor.

Me qëllim zbatimin nga Republika e Shqipërisë të masave shtrënguese ndërkombëtare të ndërmarra në kuadër të rezolutave të (KS)-së, natyra e të cilave nuk lidhet me terrorizmin apo financimin e terrorizmit, ka lindur nevoja e krijimit të një baze ligjore për zbatimin e tyre.

Ne fjalën e saj përmbyllëse znj.Dralo, theksoi se objektivi kryesor i politikës që propozohet me kete projektligj është përcaktimi në mënyrë të detajuar i llojeve të sanksioneve ndërkombëtare, procedurave dhe mekanizmave të vendosjes së këtyre sanksioneve, mekanizmave të zbatimit dhe monitorimit të masave shtrënguese, procedurave dhe mekanizmave të ankimit ndaj sanksioneve.

Kjo politikë synon të kontribuojë në:

- paqen dhe sigurinë rajonale e ndërkombëtare;
- promovimin e respektit për të drejtën ndërkombëtare dhe të drejtat e njeriut;
- përkrahjen e parimeve demokratike dhe sundimit të ligjit;
- të zbatojë detyrimet që burojnë nga anëtarësimi i vendit tonë në organizata ndërkombëtare si dhe, nga dëshira për anëtarësim në organizata ndërkombëtare;
- të sigurojë zbatimin e efektshëm të masave shtrënguese ndërkombëtare me fokus parandalimin e përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë, duke ngrirë fondet dhe pasuritë e subjekteve përkatëse si dhe,
- të vendosë sanksione për subjektet që dështojnë t'i binden atyre

Anëtarët e Komisionit të Sigurisë u shprehën dakort në parim me projektligjin dhe vijuan diskutimet dhe pyetjet në çështjet që lidhen me rëndësinë e projektligjit; cilat janë kriteret e përzgjedhjes së personit (specialistit) pranë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, që do të merret me ndjekjen e procedurës së ekzekutimit të sanksioneve dhe realizimin e raportimeve, çfarë masash janë parashikuar për subjektet që nuk zbatojnë këto masa ndëshkuese etj.

Gjithashtu, gjatë diskutimit nën për nën anëtarët e komisionit u ndalën në çështje më konkrete në funksion të përmirësimit të këtyre dispozitave.

• **Riformulime nën për nën**

Komisioni për Sigurinë Kombëtare bazuar në çështjet e parashtruara dhe sugjerimet e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut si dhe nga diskutimi nën për nën i projektligjit, i propozon seancës plenare si më poshtë:

Për teknikë legjislativë kudo në ligj fjala “shkronja” të zëvendësohet me fjalën “gërma”.

Neni 2, fjala “rregullon” të zëvendësohet me fjalën “përcakton” (sugjerim i propozuar nga Komisioni i Ligjeve), dhe neni të riformulohet si më poshtë:

“Ky ligj përcakton procedurën e vendosjes, të zbatimit, ndryshimit e shfuqizimit të masave shtrënguese ndërkombëtare, të cilat Republika e Shqipërisë i vendos, zbaton, ndryshon ose shfuqizon në përputhje me Kushtetutën, të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të, rezolutave të miratuara nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, vendimet e miratuara nga organizatat ndërkombëtare në të cilat ajo është shtet anëtar, si edhe me këtë ligj.”

Neni 4, pika 10, komisioni pranoi sugjerimin e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut përse i përket riformulimit të saj e cila riformulohet si më poshtë:

“Organizime ligjore”, trustet, (një marrëveshje me anë të së cilës një person në mirëbesim mban pronën si pronar nominal për të mirën e një ose më shumë përfituesve) apo marrëveshje të tjera të ngjashme.”

Neni 6, pika 1 fjala “rregullojnë” zëvendësohet me fjalën “përcaktojnë” (sugjerim i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut), fjala “shkronja” zëvendësohet me fjalën “gërma” dhe neni riformulohet si më poshtë:

“Dispozitat e këtij neni përcaktojnë procedurat e vendosjes, zbatimit, ndryshimit dhe shfuqizimit të masave shtrënguese të parashikuara në gërmat “b” dhe “c”, të pikës 3, të nenit 3, të këtij ligji.”

Neni 11, pika 1, gërma “b”, pas togfjalëshit “për punët e brendshme” shtohet togfjalëshi “dhe strukturat në varësi të saj” duke u riformuluar si më poshtë:

“b) ministria përgjegjëse për punët e brendshme dhe strukturat në varësi të saj, për masat shtrënguese lidhur me ndalimin e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë”

Neni 18, pika 4, hiqet fjala “me qëllim apo” dhe fjalia riformulohet si më poshtë:

“Për dëmet e shkaktuara në zbatim të rezolutave të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara ose vendimeve të organizatave ndërkombëtare nuk mund të kërkohet dëmshpërblim nga shteti shqiptar, përveç rasteve kur dëmi është shkaktuar me faj nga ky i fundit.”

Neni 19, pika 6, komisioni pranoi sugjerimin e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut përse i përket riformulimit të kësaj pike e cila ndryshohet si më poshtë:

“Kundër vendimit të organeve përgjegjëse për zbatimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, subjektet pasi kanë shteruar të gjitha mjetet e ankimit administrativ, mund të paraqesin ankim pranë gjykatës administrative, në përputhje me rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

Neni 20 hiqet duke pranuar edhe sugjerimin e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Neni 21, bëhet neni 20 dhe afati për nxjerrjen e akteve nënligjore nga “6 mujour” bëhet “3 mujour” dhe neni ndryhohet si më poshtë:

Neni 20

Aktet nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktet nënligjorë në zbatim të neneve 6 pika 8, 10 pika 6, 14 pika 6 dhe 15 pika 5 të tij.

Neni 22 bëhet neni 21.

- ***Përfundim***

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nën për nen dhe në tërësi, me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm në mbledhje e miratoi atë duke vlerësuar se:

- ***Në aspektin ligjor***, projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.
- ***Në aspektin procedural***, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Relatore

Artemis DRALO

Kryetar

Ermonela (Felaj) VALIKAJ